

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA E PODUJEVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **615-25-804-5-1-1**

Sa i përket tenderit për: **“Asfaltimi i rrugës Llapshiticë-Popovë”**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

BENI - COM SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Shkabaj, Obiliq

(Adresa)

Obiliq

(Vendi)

15000

(Kodi postar)

045/444999

(Numri Telefonit)

-

(Numri i Faks-it)

Muhamet Kunushefci

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

beni-com@hotmail.com

(Adresa elektronike)

27.03.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

N/A

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Autoriteti Kontraktues KOMUNA E PODUJEVËS për aktivitetin e prokurimit “Asfaltimi i rrugës Llapashiticë-Popovë” me nr. prokurimi: 615-25-804-5-1-1, ka publikuar këto njoftime:

1. Publikimi i Njoftimit për kontratë me datë 14.02.2025
Procedurë e hapur
Lloji i kontratës – Punë
Vlera e parashikuar – 1,624,500.00€
Kriteri për dhënien e kontratës : Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët
Afati i fundit për dorëzimin e tenderit me 07.04.2025
2. Njoftim Vendimi i AK-së i dt. 18.06.2025
3. Kërkesa për rishqyrtim mbi vlerësimin fillestar i dt. 21.06.2025
4. Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim i dt. 24.06.2025
5. Ankesa në OSHP mbi vlerësimin fillestar i dt. 04.07.2025
6. Vendimi i PSH me nr. 2025/0601 i dt. 17.09.2025 përmes të cilit është aprovuar ankesa e OE ankues “BENI – COM SH.P.K.”, është anuluar vendimi për dhënien e kontratës dhe është obliguar AK që lëndën ta kthejë në rivlerësim dhe ti vlerësoj dhe krahasoj tenderët e përgjegjshëm sipas kritereve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës/dosjen e tenderit.
7. Njoftim Vendimi i AK-së për rivlerësimin e parë i dt. 07.11.2025
8. Kërkesa për rishqyrtim mbi rivlerësimin e parë i dt. 12.11.2025
9. Vendimi mbi aprovimin e pjesshëm të kërkesës për rishqyrtim i dt. 12.11.2025
10. Njoftim Vendimi i AK-së për rivlerësimin e dytë i dt. 16.12.2025
11. Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim 23.12.2025
12. Ankesa në OSHP e dt. 02.01.2026
13. Vendimi OSHP: 2026/0001 i dt. 19.02.2026, përmes të cilit është aprovuar ankesa e OE “BENI – COM SH.P.K.”, është anuluar vendimi për dhënien e kontratës dhe është obliguar AK që lëndën ta kthejë në rivlerësim.
14. Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 11.03.2026.
15. Kërkesa për Rishqyrtim e datës 16.03.2026.
16. Vendimi për Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim 18.03.2026.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Më 16.03.2026 ne kemi parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim, mirëpo e njëjta më 18.03.2026 është refuzuar në tërësi nga AK, prandaj brenda afatit ligjor ne i drejtohem Organit Shqyrtues të Prokurimit për të kërkuar mbrojtje ligjore dhe respektim të plotë të legjislacionit të prokurimit publik.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 54 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së
Neni 105 i LPP-së
Neni 27 i RrPP-së
Neni 40 i RrPP-së
Neni 62.2 i RrPP-së
Neni 97.1., pika (h) i RrPP-së
Neni 48 i LPPA-së

** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Rrjedha e procedurës:

1. Më datën 14 Shkurt 2025, **AK – “KOMUNA E PODUJEVËS”** përmes platformës publike e-prokurimi ka shpallur iniciimin e aktivitetit të prokurimit me titull: **“Asfaltimi i rrugës Llapashticë-Popovë”** me nr. prokurimi: **615-25-804-5-1-1**.
2. Kompania jonë, pra Operatori Ekonomik **BENI COM SH.P.K.** ka marrë pjesë në këtë aktivitet të prokurimit në grup me **OE ETEAM SH.P.K. & LINDA** duke dorëzuar dosjen e tenderit brenda afatit të përcaktuar ligjor dhe duke i plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit. Në këtë aktivitet të prokurimit janë pranuar pesë (5) oferta, të cilat janë:

Nr.	Operatori Ekonomik	Çmimi (me TVSH)
1	NNT ABC SH.P.K.	1,352,847.15 €
2	Grup i Operatorëve Ekonomik BENI - COM SH.P.K.; ETEAM SH.P.K.; Linda	1,470,620.69 €
3	Grup i Operatorëve Ekonomik FS C ING SH.P.K.; EL-BAU SH.P.K.	1,544,942.14 €
4	Rahovica Commerce SH.P.K.	1,552,730.86 €
5	Grup i Operatorëve Ekonomik Quality Asphalt SH.P.K.; N.N.SH. EORLD MEDIUM; CAPITAL X FET SH.P.K.	1,731,305.93 €

3. Autoriteti Kontraktues me datën 18.06.2025 ka bërë publikimin e Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, tek i cili vendim AK rekomandon për shpërblim me kontratë **Grupin e Operatorëve Ekonomik FS C ING SH.P.K.; EL-BAU SH.P.K.** dhe ofertën tonë e refuzon si të papërgjegjshme duke mos zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme dispozitat ligjore procedurale dhe materiale të LPP-së.
4. Menjëherë pas pranimit të këtij Vendimi ne kemi bërë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare me dt. 18.06.2025 ku pastaj qasja është mundësuar me datën 19.06.2025. Ne pastaj kemi vazhduar me Kërkesë për Rishqyrtim e cila u refuzuar nga ana e AK-së për të vazhduar me ankesë në OSHP.
5. OSHP me anë të vendimit të dt. 17.09.2025 e aprovon kërkesën tonë si pjesërisht të bazuar dhe lëndën e kthen në rivlerësim.
6. Pas pranimit të këtij vendimi, AK nuk nxjerr asnjë vendim deri me datë 07.11.2025 pra plot 52 ditë nga vendimi i OSHP-së.
7. Më 07.11.2025, AK publikoi vendimin e radhës, i cili ishte i pritshëm. Duke mos e zbatuar vendimin e OSHP-së dhe duke përsëritur shkeljet e mëparshme, AK kësaj radhe vendosi për shpërblim me kontratë një OE tjetër të papërgjegjshëm: Rahovica Commerce SH.P.K.
8. Menjëherë pas pranimit të këtij vendimi për rivlerësimin, më 09.11.2025, ne kemi dorëzuar kërkesë për qasje në dokumentet zyrtare. Kjo qasje është realizuar më 10.11.2025, ku kemi pasur mundësinë të shqyrtojmë dokumentacionin përkatës të procedurës së rivlerësimit të parë. Ne pastaj kemi vazhduar me Kërkesë për Rishqyrtim

e cila është aprovuar pjesërisht nga ana e AK-së dhe lënda është kthyer në rivlerësim prapë.

9. Më 16.12.2025, AK publikoi vendimin e radhës, i cili ishte poashtu i pritshëm. Duke mos e zbatuar vendimin e OSHP-së dhe duke përsëritur shkeljet e mëparshme, AK kësaj radhe vendosi të rekomandoj anulimin e procedurës në mungesë të ofertave të përgjegjshme.
10. Menjëherë pas pranimit të këtij Vendimi ne kemi bërë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare me dt. 16.12.2025 ku pastaj qasja është mundësuar me datën 17.12.2025. Pas sigurimit të dokumentacionit, më 21.12.2025 kemi parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim.
11. Pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim, ne më 02.01.2026 kemi parashtruar ankesë pranë OSHP-së, ndërsa OSHP më 19.02.2026 nxjerrë Vendimin OSHP: 2026/0001 duke e aprovuar ankesën tonë dhe duke e kthyer lëndën në rivlerësim.
12. Me këtë vendim të OSHP-së, përkundër se kanë qenë të parashtruara gjithsej tri ankesa konkretisht ankesa e OE BENI COM SH.P.K. me numër OSHP: 2026/0001 (Ankesa e OE FS C ING SH.P.K me numër 2025/1290 dhe ankesa e OE Rahovica Commerce SH.P.K. me numër 2026/0002, vetëm lidhur me ankesën e OE BENI -COM SH.P.K lënda është kthyer në rivlerësim, ndërsa lidhur me ankesat e dy OE-ve tjerë të cituar më lartë ka mbetur në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e AK-së.
13. AK më 11.03.2026 në kundërshtim të plotë me gjetjet dhe udhëzimet e Panelit Shqyrtues të saktësuar në Vendimin OSHP: 2026/0001, e njëjta kundërligjshëm na eliminon nga gara si të papërgjegjshëm, ashtu që eliminon në tërësi këtë aktivitet të prokurimit.
14. Ne më 16.03.2026 kemi parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim, ndërsa nëpërmjet Vendimit të datës 18.03.2026, AK ka refuzuar në tërësi këtë kërkesë, duke e lënë në fuqi Njoftimin mbi Vendimin e AK-së të datës 11.03.2026.

Ne si OE i vetëm i përgjegjshëm i konfirmuar me Vendimin OSHP: 2026/0001 të datës 19.02.2026, të pakënaqur me këtë vendim të AK-së, brenda afatit ligjor paraqesim këtë Ankesë dhe atë mbi këto pretendime ankimore.

PRETENDIMI 1: Mos trajtim i pretendimeve ankimore dhe arsytim i pabazuar, i papranueshëm, arbitrar dhe denigrues nga Autoriteti Kontraktues në Vendimin refuzues lidhur me Kërkesën për Rishqyrtim

Autoriteti Kontraktues, përmes vendimit për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, ka dështuar në mënyrë flagrante që të përmbushë një nga detyrimet më themelore ligjore, konkretisht trajtimin e plotë, të drejtë dhe të arsyetuar të pretendimeve ankimore të paraqitura nga OE “BENI-COM SH.P.K.”.

Një veprim i tillë nuk përbën thjesht mangësi procedurale, por shkelje serioze të standardeve të një procesi të rregullt administrativ dhe të vetë parimeve mbi të cilat ndërtohet sistemi i prokurimit publik në Kosovë.

Kërkesa jonë për rishqyrtim ka ngritur pretendime të qarta, konkrete dhe juridikisht të artikuluara, të cilat lidhen drejtpërdrejt me: karakterin përfundimtar të çështjeve të trajtuara përmes Vendimit të fundit të OSHP-së (Res judicata); moszbatimin e detyrimeve të qarta

dhe të detyrueshme që burojnë nga Vendimi OSHP: 2026/0001, tendencë për të ndryshuar në mënyrë fiktive gjendjen faktike si dhe tejkallim të kompetencave nga ana e AK përmes rihapjes së çështjeve tashmë të mbyllura dhe të vlerësuara nga OSHP.

Pavarësisht kësaj, vendimi refuzues i AK-së nuk përmban asnjë trajtim substancial të këtyre pretendimeve. Nuk ekziston asnjë analizë juridike, asnjë shqyrtim i provave dhe asnjë arsyetim që do të mund të justifikonte refuzimin. Në vend të kësaj, AK ka zgjedhur të injorojë në tërësi pretendimet tona dhe të devijojë nga objekti i shqyrtimit, duke e bërë vendimin e tij jo vetëm të paarsyetuar, por edhe arbitrar. Në këtë drejti, një vendim i cili nuk i përgjigjet pretendimeve ankimore, në thelb është vendim i pavlefshëm, pasi mungesa e arsytimit e bën të pamundur kontrollin e ligjshmërisë së tij dhe cenon drejtpërdrejt të drejtën për mjet juridik efektiv.

Edhe më shqetësuese është natyra e arsytimit të përdorur nga AK. Në vend që të mbështetet në analiza faktike dhe juridike, AK ka përdorur një gjuhë të papranueshme për një akt administrativ, duke përfshirë pretendime të rënda, të pabazuara dhe denigruese, të cilat nuk mbështeten në asnjë vendim përfundimtar të ndonjë organi kompetent.

Një qasje e tillë nuk ka të bëjë me vlerësimin e ligjshëm të një oferte, por paraqet një përpjekje të hapur për të zhvendosur fokusin nga shkeljet procedurale dhe nga moszbatimi i vendimeve të OSHP-së, drejt krijimit të një narrative të pabazuar dhe shpifëse që cenon reputacionin e operatorëve ekonomik pjesë e konsorciumit.

Për më tepër, përmes këtij arsytimi, AK ka tejkalluar çdo kufi të pranueshëm institucional duke prekur në mënyrë të papërgjegjshme edhe integritetin e një institucioni të pavarur si Organi Shqyrtues i Prokurimit. Insinuatat dhe referencat e tilla, të pambështetura dhe jashtë çdo konteksti juridik, janë jo vetëm të papranueshme, por edhe të rrezikshme për besimin publik në sistemin e prokurimit dhe në institucionet e tij.

Theksojmë se një autoritet kontraktues nuk është organ hetimor dhe as organ gjyqësor, dhe si i tillë nuk ka as kompetencë e as autoritet që përmes një vendimi administrativ të atribuojë veprime të natyrës mashtruese apo të ndërtojë pretendime që cenojnë reputacionin e operatorëve ekonomikë dhe institucioneve, pa një bazë të qartë dhe të konfirmuar ligjore.

Një gjuhë e tillë, përveçse është thellësisht joprofesionale, është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me parimet e paanshmërisë dhe objektivitetit që duhet të udhëheqin çdo autoritet kontraktues gjatë ushtrimit të kompetencave të tij, prandaj me këtë arsyetim AK ka shkelur rëndë edhe nenin 7, paragrafi 1 të LPP-së i cili taksativisht thekson se: *“Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”*. Gjithashtu bazuar në nenin nenit 62, paragrafi 2 të RrPP-së përcaktohet qartë se: *“Vendimi mbi refuzimin do të arsyetohet dhe do të publikohet në sistemin e prokurimit elektronik nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit”*.

Përveç kësaj, Vendimi i AK-së është në kundërshtim edhe me Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili në nenin 48, paragrafi 1, nënparagrafi 5, përcakton se arsyetimi i aktit administrativ duhet të përmbajë: *“Shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve”*.

Përfundimisht, kombinimi i mos-trajtimin të pretendimeve ankimore dhe përdorimit të një arsytimi të pabazuar, denigrues, shpifës dhe jashtë çdo standardi administrativ, e bën këtë vendim jo vetëm të kundërligjshëm, por edhe të papranueshëm në aspektin institucional dhe

profesional. Si i tillë, i njëjti nuk mund të qëndrojë dhe duhet të anulohet në tërësi nga Organi Shqyrtues i Prokurimit.

PRETENDIMI 2: Arsyeya e eliminimit të ofertës sonë është “Res Judicata” me Vendimin OSHP: 2026/0001

AK na eliminon nga ky aktivitet i prokurimit mbi këtë arsye:

ARSYETIM : Grupi OE: BENI-COM SH.P.K.; ETEAM SH.P.K.; Linda -Prishtinë
Gjatë vlerësimit është konstatuar se operatori ekonomik BENI COM SH.P.K. nuk i ka dëshmuar pajisjet me foto sipas kërkesës. Konkretisht: Për cilindrin me dhëmbëza (min. 21.5 ton), dëshmia e ofruar nga OE nuk është në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit, pasi: OE ka ofruar marrëveshje me kompaninë EUROVIA, e cila nuk përmban DUD-in doganor që vërteton se cilindri është me dhëmbëza;
OE- është i papërgjegjshëm për pajisjen cilindër me dhëmbëza (min. 21.5 ton), pasi dëshmia e ofruar (fotografia) nuk korrespondon me pajisjen e verifikuar në terren. Në Dosjen e Tenderit (DT) është ngarkuar një fotografi ku pajisja paraqitet si cilindër me vëmza, ndërsa pas verifikimit fizik në terren është konstatuar se pajisja është cilindër i lëmuar dhe jo me vëmza, siç është prezantuar në fotografinë e dorëzuar.

Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 11.03.2026

Fillimisht duhet sqaruar se kjo çështje është trajtuar me Vendimin OSHP: 2026/0001 të datës 19.02.2026 dhe bazuar në nenin 105, paragrafi 2.16 të LPP-së, kjo çështje është “Res Judicata”.

Argumentim pse kjo çështje është “Res Judicata”

Së pari, çështja e fotografisë së pajisjes- cilindrit BOMAG BW 225-D3 të ofruar nga OE BENI COM SH.P.K.

1. AK lidhur me këtë aktivitet të prokurimit neve si kompani ndër tjerash me Njoftimin mbi Vendimin e AK-së të datës 16.12.2025 na kishte eliminuar për faktin kinse: *“Gjatë vlerësimit është konstatuar se operatori ekonomik BENI COM SH.P.K. **nuk i ka dëshmuar pajisjet me foto sipas kërkesës.** Konkretisht: Për cilindrin me dhëmbëza (min. 21.5 ton), dëshmia e ofruar nga OE nuk është në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit, pasi: OE ka ofruar marrëveshje me kompaninë EUROVIA, e cila nuk përmban DUD-in doganor që vërteton se cilindri është me dhëmbëza”.*¹
2. Ne si kompani fillimisht nëpërmjet Kërkesës për Rishqyrtim të datës 21.12.2025, përderisa jemi përgjegjës ndaj pretendimit për eliminim të AK-së, në mënyrë shumë të qartë kemi theksuar se: *“Vlen të theksohet se tek asnjë nga ofertuesit, në DUD-in doganor nuk është specifikuar ky detaj teknik, ngase në praktikë ai dëshmohet përmes fotografive dhe të dhënave vizuale të pajisjes. Për këtë arsye, **ne kemi paraqitur fotografi të modelit të ofruar “BOMAG BW 225-D3”, vetëm për të ilustruar dhe vërtetuar se i njëjti model është cilindër me vëmza,** që përmbush plotësisht kërkesën e përcaktuar në Dosjen e Tenderit”*².

PROVË: Kërkesa për Rishqyrtim e datës 21.12.2025

¹ Shih Kërkesa për Rishqyrtim e datës 21.12.2025, faqe 5, pretendimi 1.

² Shih Kërkesa për Rishqyrtim e datës 21.12.2025, faqe 6, paragrafi 1.

3. Pastaj, nëpërmjet Ankesë së parashtruar pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit më 02.01.2026, gjithashtu në mënyrë të qartë e kemi theksuar se: *“Sa i përket fotografisë, vlen të theksohet se edhe në kërkesën për rishqyrtim, ne kemi sqaruar qartë se fotografitë e bashkëngjitura nuk janë paraqitur si dëshmi përfundimtare e pajisjes konkrete, por vetëm si ilustrim teknik i modelit “BOMAG BW 225-D3”, me qëllim të dëshmimit se ky model, sipas specifikimeve të prodhuesit, është cilindër me vëmza (xhembra) dhe përmbush kërkesën e përcaktuar në Dosjen e Tenderit. Për më tepër, për të shmangur çdo paqartësi artificiale të krijuar nga AK, në **Aneksin 1** të kësaj ankese në OSHP i kemi bashkëngjitur fotografitë reale të pajisjes konkrete të ofruar, të cilat dëshmojnë qartë dhe pa asnjë dyshim se pajisja e ofruar është cilindër me vëmza (xhembra) dhe se përputhet plotësisht me modelin e deklaruar “BOMAG BW 225-D3”³.*

PROVË: Ankesa e datës 02.01.2026 së bashku me aneks 1.

4. Tutje, kjo çështje është trajtuar edhe nga eksperti shqyrtues z. Ilir Halili, i cili nëpërmjet raportit të ekspertizës së datës 30.01.2026, lidhur me lëndën 2026/0001, potencon: **“OE ankues përmes ankesës në OSHP ka ofruar sqarime të detajuara dhe bindëse si kundërpërgjigje në të gjitha pipkiat e eliminimit nga AK, si për pajisje ashtu edhe për staf profesional. Arsyetimi i AK-së në refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas mendimit të ekspertit nuk ka qenë bindës pasi mungesa e ndonjë të dhëne për pajisjen në dokument zyrtar (psh DUD doganor), nuk nënkupton se pajisjes i mungon specifika apo funksioni i caktuar, kjo pasi dokumentet standarde siq janë DUD doganor nuk mund të përmbajnë të gjitha të dhënat./specifikat e vëna nga AK në dosje të tenderit. Bazuar në këto që u cekën më lart vlrësojmë se pretendimet ankimore kundrejt arsyeve të AK për eliminuim të OE ankues janë të bazuara”**.⁴

PROVË: Raporti i ekspertizës i datës 30.01.2026.

5. Ndërsa përfundimisht çështja e fotografive dhe pajisjes së ofruar ka përfunduar nëpërmjet Vendimit OSHP: 2026/0001 të datës 19.02.2026, ku Paneli shqyrtues taksativisht thekson se: *“Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruara nga OE ankues lidhur me arsyet e eliminimit PSH ia fal besimin përgjegjeve të dhëna në raportin e ekspertizës si dhe si të tilla i konsideron si çështje të gjykuara me vendimin paraprak të OSHP-së lidhur me këtë aktivitet të prokurimit me nr: 615-25-804-5-1-1”*. Ndërsa në rivlerësim AK ka pasur vetëm një DETYRË dhe atë të kërkojë informata shtesë nga AK BENI-COMSH.P.K., lidhur me kontratën e inxhinierit gjeodet.⁵
6. Pra, pas gjithë këtyre konfirmimeve e rikonfirmimeve si nga ne si OE, si nga eksperti dhe Paneli Shqyrtues, AK nëpërmjet Njoftimit mbi Vendimin e AK-së të datës 11.03.2025 konstaton se: *“Gjatë vlerësimit është konstatuar se operatori ekonomik BENI COM SH.P.Knuk i ka dëshmuar pajisjet me foto sipas kërkesës. Konkretisht: Për cilindrin me dhëmbëza (min. 21.5 ton), dëshmia e ofruar nga OE nuk është në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit, pasi: OE ka ofruar marrëveshje me kompaninë EUROVIA, e cila nuk përmban DUD-in doganor që vërteton se cilindri*

³ Ankesa e datës 02.01.2026, faqe 8, paragrafi i fundit.

⁴ Raporti i ekspertit i datës 30.01.2026, faqe 20, përgjigje ndaj pretendimit ankimor nr. 1.

⁵ Vendimi OSHP: 2026/0001 i datës 19.02.2026, faqe 29, par.4.

është me dhëmbëza; OE- është i papërgjegjshëm për pajisjen cilindër me dhëmbëza (min. 21.5 ton), pasi dëshmia e ofruar (fotografia) nuk korrespondon me pajisjen e verifikuar në terren. Në Dosjen e Tenderit (DT) është ngarkuar një fotografi ku pajisja paraqitet si cilindër me vemza, ndërsa pas verifikimit fizik në terren është konstatuar se pajisja është cilindër i lëmuar dhe jo me vemza, siç është prezantuar në fotografinë e dorëzuar”.

7. Lidhur me cilindrin BOMAG BW 225-D3, ashtu siç e kemi përsëritur disa herë, ne kemi cekur qysh në fillim se fotografitë e bashkëngjitura në ofertë janë ilustrative dhe jo të karakterit përfundimtar, madje në ankesën e datës 02.01.2026 kemi bashkëngjit fotografi reale të pajisjes, ku nëpërmjet Vendimit OSHP: 2026/0001 të datës 19.02.2026, është konfirmuar se ne i plotësojmë të gjitha kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe jemi operatori i vetëm i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit, ndërsa Vendimi i AK-së i datës 11.03.2026 është krejtësisht i kundërligjshëm, dhe me tendenca të hapura mos përfillëse ndaj Vendimit meritot të OSHP-së.
8. Përfundimisht çështja e cilindrit BOMAG BW 225-D3 dhe fotografive, përveç se i ka kaluar të gjitha filtrat ligjor dhe procedural, ajo tanimë është e karakterit “Res judicata”, ndërsa Vendimi i AK-së i datës 11.03.2026, e ka vetëm një emërtim dhe ajo është mos përfillje e vendimit meritot dhe përfundimtar të OSHP-së.

Së dyti, Cilindri BOMAG BW 225-D3 është apo jo me vëmbëza

1. Autoriteti kontraktues në Njoftimin mbi Vendimin e AK-së të datës 11.03.2026 thekson se : *“OE- është i papërgjegjshëm për pajisjen cilindër me dhëmbëza (min. 21.5 ton), pasi dëshmia e ofruar (fotografia) nuk korrespondon me pajisjen e verifikuar në terren. Në Dosjen e Tenderit (DT) është ngarkuar një fotografi ku pajisja paraqitet si cilindër me vemza, ndërsa pas verifikimit fizik në terren është konstatuar se pajisja është cilindër i lëmuar dhe jo me vemza, siç është prezantuar në fotografinë e dorëzuar”.*
2. Fillimisht duhet të ndalemi tek procesverbali ku përfaqësuesi i kompanisë BENI-COM SH.P.K., është lajthitur kundërligjshëm, në mënyrë tinëzare dhe me tendenca mashtruese nga kryesuesi i komisionit z. Ardian Emini, Deklarojmë nën betim se në momentin kur përfaqësuesi i kompanisë z. Konushefci ka vendosur nënshkrimin në atë proces ka qenë i shënuar vetëm numri i shasisë së pajisjes dhe na është thënë nga z. Ardian Emini të nënshkruajmë si dëshmi që AK ka qenë në kontrollë, ndërsa të dhënat tjera në mënyrë tinëzare dhe qëllimkeqe i kanë plotësuar pas nënshkrimit tonë në atë proces dhe pasi janë larguar nga terreni. (Ndaj zyrtarëve përgjegjës do të fillojmë procedurat penale për mashtrim).
3. Deklarojmë nën betim se as kryesuesi dhe asnjë anëtarë i komisionit gjatë vizitës së pajisjes nuk e kanë diskutuar apo ngritur si diskutim çështjen e vëmbzave, duke nënkuptuar se për ta nuk kishte asgjë diskutuese. Prandaj, kundërligjshëm na kanë mashtruar, ashtu që të krijohet argumenti i rrejshëm se kinse përfaqësuesi i BENI-COM ka nënshkruar dhe është pajtuar se Cilindri BOMAG BW 225-D3 qenka cilindër i lëmuar (Smooth Drum Roller). Për të dëshmuar këtë mashtrim nga AK, si dëshmitarë është edhe z. Drilon Etemi, përfaqësues i kompanisë ETEAM SH.P.K. i cili ka qenë prezent gjatë vizitës së pajisjes dhe njëherit është edhe anëtarë i konsorciumit në këtë aktivitet të prokurimit.

4. Gjithashtu me qëllime tendencioze për ta sajuar situatën kinse ne nuk i plotësojmë kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me këtë pajisje, pa prezencën tonë AK në procesverbal e shënon se pajisja e ofruar nga ne është cilindër i rrafshët (Smooth Drum Roller), ndërsa në etiketën e pajisjes shumë qartë shënon: “Single Drum Roller”. Për të vërtetuar këtë gjëni fotografitë më poshtë:

PROCESVERBAL

Bazuar në vendimin e komisionit për ri-vlerësimin e ofertave në tenderin “Asfaltimi i rrugës Ulpashticë – Popovë”, me nr. të prokurimit 615-25-804-5-1-1, të nxjerrë nga Kryetari i Komunës me nr. të protokollit 02-020/04-0010785/26, të datës 20.02.2026.

Data: 10.03.2026
 Vendi: Rabovc
 Koha: 10:55

Komisioni, në përberje të plotë, me qëllim të verifikimit fizik të njërit nga pajisjet e kërkuara në dosjen e tenderit, më datë 10.03.2026, ka verifikuar pajisjen Cilindër me vëmra për ngjeshje, me peshë minimale 21.5 ton.

Pajisja: Cilindër i lëmuar (smooth drum roller) 24700/26000 kg

Nr. i shasisë: 101580651060

Përfaqësuesi përgjegjës i kompanisë: Muhamed Komusheti

Foto 1: Procesverbali i AK-së



Foto 2: Etiketa e pajisjes

5. Bazuar në këtë, tendencat e AK-së janë të qarta, rrjedhimisht që kundërligjshëm të ndryshohet gjendja faktike me qëllimin e vetëm që ne të eliminohejmë nga gara, përkundër se të gjitha këto çështja tanimë janë të trajtuara nga Vendimi OSHP: 2026/0001 të datës 19.02.2026 dhe lënda është kthyer në rivlerësim për krejt diçka tjetër.
6. Edhe njëherë e bëjmë të qartë se cilindri BOMAG BW 225-D3 të cilin ne e kemi ofruar, ashtu siç vërehet nga fotografitë e realizuara nga vizita e AK-së, ashtu edhe nga fotografitë që kanë qenë pjesë e ankesës sonë të datës 02.01.2026, është qartësisht me vëmbëza.
7. Nga fotografitë që vetë AK ka bashkëngjitur në Raportin e Vlerësimit, shihet qartë se pajisja është me vëmbëza e jo siç pretendon autoriteti kontraktues cilindër i

lëmuar. Për më tepër shih fotografitë që vetë AK i ka bashkëngjitur në raportin e vlerësimit e që janë realizuar nga vizita e pajisjes në terren:



Fotografi nga raporti i vlerësimit i datës 11.03.2026



Fotografi nga raporti i vlerësimit i datës 11.03.2026

8. Në vazhdim po e ilustruam me fotografi se si duket cilindri "Smooth Drum Roller" që pretendon AK dhe si duket BOMAG BW 225-D3 "Single Drum Roller", të cilin e kemi ofruar ne:



Cilindri "Smooth Drum Roller" që pretendon AK



Cilindri "Single Drum Roller" që e ka ofruar BENI-COM SH.P.K.

9. Prandaj qëndrimi i AK-së është tërësisht i pabazuar për faktin se cilindri BOMAG BW 225-D3 të cilin e kemi ofruar qartësisht nuk ka sipërfaqe të lëmuar (Smooth Drum Roller) siç pretendohet nga AK, mirëpo i njëjti qartësisht është me vëmbëza, ndërsa çështja e fotografive ilustruese ka kohë që është sqaruar nga ne si kompani.
10. Në vendimin refuzues të Kërkesës për Rishqyrtim, AK në asnjë moment nuk merret me argumentet dhe provat e bashkëngjitura në Kërkesë për Rishqyrtim, por vetëm thekson se pajisja mund të verifikohet kinse për të vërtetuar pretendimin e tyre, përkundër që ne kemi dhënë argumente të qarta se gjendja faktike që vetë AK ka pasqyruar me fotografi, por edhe me procesverbalin e përpiluar nën lajthitje është krejtësisht ndryshe nga ajo që shkruhet në raport të vlerësimit dhe në Njoftimin mbi Vendimin e AK-së të datës 11.03.2026
11. Përfundimisht AK nuk ka respektuar Vendimin OSHP: 2026/0001, kur ka eliminuar ofertën tonë mbi fakte të paqëndrueshme dhe të trajtuara nga Paneli Shqyrtues, të cilat tani kanë statusin e "Res Judicata", sipas nenit 105, paragrafi 2.16 të LPP-së.

PRETENDIMI 3: AK nuk ka zbatuar Vendimin OSHP: 2026/0001

1. Lidhur me njoftimin mbi Vendimin e AK-së të datës 16.12.2025, pranë OSHP-së janë dorëzuar gjithsej tri ankesa, konkretisht ankesa e OE BENI-COM SH.P.K. me numër OSHP: 2026/0001, ankesa e OE FS C ING SH.P.K me numër 2025/1290 dhe ankesa e OE Rahovica Commerce SH.P.K. me numër 2026/0002.
2. Nga këto 3 ankesa të ngritura pranë OSHP-së, vetëm ajo e OE BENI-COM SH.P.K. aktivitetin e prokurimit e ka kthyer në rivlerësim, ndërsa dy ankesat tjera e kanë lënë në fuqi Njoftimin mbi Vendimin e AK-së të datës 16.12.2025 lidhur me eliminimin

e tyre. Me fjalë të tjera e vetmja ofertë për të cilën aktiviteti i prokurimit është kthyer në rivlerësim, është oferta e OE BENI –COM SH.P.K.

PROVË: Shih Vendimin OSHP: 2026/0001

3. Sipas Vendimit OSHP: 2026/0001, e vetmja çështje “e hapur” ka mbetur kontrata për inxhinierin-gjeodetin, ku Paneli Shqyrtues në mënyrë shprehimore ka OBLIGUAR AK-në të kërkojë sqarime shtesë sipas nenit 72 të LPP-së. Për korrektësi po e citojmë qëndrimin e Panelit Shqyrtues lidhur me këtë çështje: *“Ndërsa lidhur për përgjigjen tjetër të dhënë nga eksperti në këtë sqarim sa i përket kontratës apo parakontratës **PSH obligon AK që në zbatim të dispozitës ligjore të nenit 72 të LPP-së të kërkoj sqarime shtesë** pasi për inxhinierin e pretenduar OE ankues ka paraqitur Diplomë , CV , referenca si dhe licencë”⁶.*
4. AK në vend që të zbatonte obligimet nga Vendimi OSHP: 2026/0001, i njëjti merret me çështje tanimë të trajtuara, madje duke vënë në lajthim përfaqësuesin e OE BENI –COM SH.P.K., konkretisht duke e mashtruar të nënshkruaj në procesverbal të vizitës së cilindrit BOMAG BW 225-D3, kinse i njëjti është i lëmuar, e jo me vëmbëza siç e ka kërkuar AK. (më gjerësisht ky mashtrim është trajtuar në pretendimin numër 2).
5. Sa i përket asaj që AK nëpërmjet Vendimit OSHP: 2026/0001 është obliguar të kërkojë sqarime shtesë për kontratën e inxhinierit gjeodet, e njëjta fare nuk kërkon infomata shtesë nga ne si OE i vetëm i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit.
6. Këto veprime të AK-së janë haptas mospërfillëse ndaj organit epror vendimmarrës, përkatësisht Panelit Shqyrtues dhe padyshim se OSHP duhet të ndërmerr masa ligjore ndaj Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit.

PRETENDIMI 3: AK me të drejtë ka eliminuar operatorët tjerë në garë

AK nëpërmjet Njoftimit mbi Vendimin e AK-së të datës 11.03.2026, nga ky aktivitet i prokurimit ka eliminuar edhe ofertat e operatorëve: NNT ABC SH.P.K., FS C ING SH.P.K., Rahovica Commerce SH.P.K. dhe Quality Asphalt SH.P.K..

AK me të drejtë ka eliminuar këta operatorë ekonomik në fjalë, për faktin se me Vendimin e fundit të OSHP-së, konkretisht Vendimin OSHP: 2026/0001, i vetmi OE i përgjegjshëm në garë ka mbetur OE BENI –COM SH.P.K.

Kërkesë për marrjen e masave ndaj Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit për shkak të mos zbatimit të vendimeve përfundimtare të OSHP-së

Vendimet e Organit Shqyrtues të Prokurimit janë përfundimtare në aspekt administrativ dhe detyruese për AK-në, prandaj çdo moszbatim i tyre përbën shkelje të rëndë të Ligjit për Prokurimin Publik dhe të Rregullores për Prokurim Publik.

Në rastin konkret, nga rrjedha e këtij aktiviteti të prokurimit dhe në veçanti nga veprimet e ndërmarra pas Vendimit OSHP: 2026/0001, rezulton qartë se Autoriteti Kontraktues,

⁶ Vendimi OSHP: 2026/0001, faqe 30, paragrafi 1.

përkatësisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, nuk ka zbatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë detyrimet e përcaktuara nga Paneli Shqyrtues, por përkundrazi ka vepruar në kundërshtim të drejtpërdrejtë me to, duke rihapur çështje të mbyllura, duke tentuar të ndryshoj gjendjen faktike lidhur me pajisjen (cilindr BOMAG BW 225-D3) dhe duke shmangur obligimet konkrete të vendosura me këtë vendim, përkatësisht duke mos kërkuar sqarime shtesë nga ne si OE ashtu siç e ka obliguar Vendimi OSHP: 2026/0001.

Veprime të tilla nuk mund të konsiderohen si vlerësim diskrecional, por përbëjnë mosrespektim të drejtpërdrejtë të një vendimi përfundimtar administrativ, gjë që cenon rëndë parimin e sigurisë juridike dhe funksionimin e sistemit të prokurimit publik.

Për më tepër, kjo nuk është një situatë e izoluar. Në Vendimin OSHP: 2025/0972, të datës 10.01.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rregullimi i rrugëve” me nr. të prokurimit 615-24-11371-2-1-1, Paneli Shqyrtues i ka shqiptuar vërejtje Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit pikërisht për moszbatim të vendimeve të OSHP-së, konkretisht citojmë: *“I shqiptohet vërejtje Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit pran AK-së. Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik, si dhe të veproj në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi dhe respektimin e vendimeve të OSHP-së në të kundërtën OSHP mund të inicoj procedurat disiplinore konformë nenit Neni 97 të Rregullorës për Prokurim Publik”*⁷.

Pavarësisht kësaj vërejtjeje të qartë dhe paralajmërimit për pasoja disiplinore, në rastin aktual konstatohet një vazhdimësi e të njëjtës praktikë të kundërligjshme, e cila dëshmon për një qasje të përsëritur dhe sistematike të mosrespektimit të vendimeve të OSHP-së. Përtej kësaj, në Vendimin për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim në mënyrë të paprecedent dhe jo profesionale tentohet të denigrohet edhe vendimmarrja pranë OSHP-së.

Në këtë kontekst, theksojmë se sipas nenit 97, paragrafi 1, pika (h) të Rregullores për Prokurim Publik, mosrespektimi i vendimeve të OSHP-së përbën bazë të drejtpërdrejtë për iniciimin e procedurave për masa ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Duke pasur parasysh natyrën detyruese të vendimeve të OSHP-së, moszbatimin e qartë të Vendimit OSHP: 2026/0001, përsëritjen e kësaj sjelljeje edhe pas shqiptimit të vërejtjes nga Paneli Shqyrtues në një rast paraprak, si dhe ndikimin që këto veprime kanë në cenimin e ligjshmërisë, transparencës dhe besimit në sistemin e prokurimit publik, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues që, përveç shqyrtimit të kësaj ankese, të ndërmarrë masa konkrete ndaj Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, në përputhje me kompetencat e tij ligjore.

Një veprim i tillë është i domosdoshëm jo vetëm për të adresuar shkeljet konkrete në këtë rast, por edhe për të parandaluar përsëritjen e praktikave të tilla në të ardhmen dhe për të ruajtur integritetin dhe autoritetin e vendimeve të OSHP-së si organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimit publik.

⁷ Për më detajisht shih Vendimin OSHP: 2025/0972, faqe 34.

Përfundim:

Përfundimisht AK, konkretisht Komisioni i Vlerësimit ka bërë shkelje të Nenit 59 paragrafi 1 të LPP-së, pasi të njëjtit janë të obliguar që të vlerësojë dhe krahasojë tenderët e përgjegjshëm sipas kritereve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe Dosjen e Tenderit. Bazuar në nenin 27, paragrafi 1, lidhur me paragrafin 3 të RrPP-së në mënyrë shumë të qartë thuhet se: *“Nëse kriteri “tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët” është kriteri i vetëm, kontrata do të jepet për tenderin me çmim më të ultë që përmbushë kërkesat e specifikuar. Nëse kriteri është ‘tenderi ekonomikisht më i favorshëm’, kontrata duhet ti jepet tenderit i cili më së miri përmbushë kriteret relevante”*. Përkundër se ne jemi OE i vetëm i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit, AK na eliminon padrejtësisht.

Komisioni i vlerësimit ka shkelur në mënyrë flagrante nenin 40, paragrafi 6 i RrPP-së, kur ka eliminuar ofertën tonë. Bazuar në këtë dispozitë, në mënyrë taksative potencohet se: *“Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur:*

a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit;

b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit;

c. është dorëzuar nga Operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit”.

Ne përkundër që kemi përmbushur të tri këto kërkesa, eliminohe mi në mënyrë të kundërligjshme nga AK.

Gjithashtu Komisioni i Vlerësimit nuk ka respektuar nenin 40 të RrPP-së, konkretisht paragrafin 1, i cili kërkon që ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve të bëhet në pajtueshmëri me parimet themelore të përcaktuara me LPP. Pastaj paragrafin 12 i cili saktëson se: *“Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit”*, dhe paragrafin 13 i cili përcakton se: *“Komisioni vlerësues do t'i vlerësojë dhe krahasojë tenderët e përgjegjshëm sipas kritereve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit”*

Gjithashtu Komisioni i Vlerësimit të AK-së ka shkelë edhe nenin 7 të LPP-së, ku në paragrafin 1 të nenit 7 parashihet qartë se: *“Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do te veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së parasheh që: “Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë: (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse”*, mirëpo AK nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Përtej këtyre, AK nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Andaj, mbi bazën e asaj që u potencua më lartë, Organit Shqyrtues të Prokurimit i propozojmë që të marrë këtë:

V E N D I M

- I.** **APROVOHET** si e bazuar Ankesa e OE “BENI-COM SH.P.K.”
- II.** **ANULOHET** Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 11.03.2026, dhe Vendimi i datës 18.03.2026, ashtu që lënda kthehet në **RIVLERËSIM**.
- III.** Inicohet procedurë për revokimin e certifikatës për Zyrtarin Përgjegjës të Prokurimit AK Komuna e Podujevës.
- IV.** **DETYROHET** AK Komuna e Podujevës që ankuesit OE “BENI-COM SH.P.K.” t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- V.** Meqë ankesa ishte e suksesshme, kthehen mjetet e deponuara në emër të ankesës nga OE BENI-COM SH.P.K.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t’i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Deri në këtë fazë të procedurës neve na janë shkaktuar dëme të jashtëzakonshme si në përgatitjen e mjeteve apeluese për kundërshtimin e vendimeve të kundërligjshme të AK-së, ashtu edhe dëme tjera procedurale për përgatitjen e ofertës dhe mirëmbajtjen e ofertës sonë valide deri më sot. Nëse AK nuk e kthen ligjshmërinë në këtë proces, ne do të detyrohemi t’i drejtohem organeve tjera ligj zbatuese për të mbrojtur interesat tona të ligjshme, përfshirë edhe kompensimin e të gjitha llojeve të dëmit.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe

g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, originalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*